REPUBLIKA E SHQIPËRISË
**BASHKIA MIRDITË**
**KËSHILLI BASHKIAK**

Nr. 4235/3 Prot

Rrëshen, më 01 . 10 . 2026

# V E N D I M

**Nr. 73 datë 25. 09. 2026**
**PËR**
**"PËRDORIM FOND REZERVË - DHËNIE NDIHMË FINANCIARE",**
**BASHKIA MIRDITË**

Në mbështetje të ligjin nr. 139/2015,"Për vetëqeverisjen vendore" *i ndryshuar*, ligji nr. 9936, datë 26.06.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", në ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017, "Për financat e vetëqeverisjes vendore", ligji nr. 87/2025, "Për buxhetin e vitit 2026", në Udhëzimin nr. 9, datë 20.07.2018, "Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit", Udhëzimin nr. 2, datë 14.01.2026, "Për zbatimin e buxhetit 2026", VKB nr. 98, datë 10.12.2025, "Për miratimin e buxhetit të vitit 2026", *relacionin nr. 4235/1 prot, datë 23.09.2026, "Mbi vlerësimin ekonomik - social të familjes të Znj. Marte Zef Gjoka & Znj. Margjela Nikoll Pjetri", nga sektori i ndihmës ekonomike, paaftësisë dhe strehimit social,* së bashku me projektin e Kryetarit Bashkisë, *shqyrtimin e miratimin në mbledhjen e datës 23.09.2026, të Komisionit Ekonomisë, Financës dhe Buxhetit,* për t'a kaluar në seancën e Këshillit Bashkiak, pas diskutimeve;

## V E N D O S I:

1. Të miratojë përdorimin e fondit rezervë, *në shumën* ***200 000*** *(dyqind mijë) lekë*, për dhënie ndihmë financiare, si vijon;

- T'i akordojë ndihmë financiare, Znj. Marte Zef Gjoka me ID; F25312017L dhe Znj. Margjela Nikoll Pjetri me ID; E55815029U, fshati Zall Xhuxhë, njësia administrative Fan, për kushte të vështira jetese

   a. **Paksim:** Fond rezervë;(A1133 00 2133001 01 V491AAA...609) në vlerën;.**200 000** lekë

   b. **Shtohet:** Pagesë;(AA133 00 2133001 01 V111AAA...606) në vlerën;.....**200 000** lekë

2. Pagesa të kalojë me bordero, në degën e Postës Mirditë, zyra Postare Rrëshen, në emër të secilës, përkatësisht me nga 100 000 (*njëqind mijë*) lekë

3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë Mirditë, (Drejtoria e Financës dhe Buxhetit)

*Ky vendim, hyn në fuqi, sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr.139/2015,"Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar.*

**S E K R E T A R**

**Gaspër TOPOLLAJ**

**K R Y E T A R**

**Aleksandër PICAKU**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA MIRDITË

ADRESA: SHESHI "ABAT DOÇI", RRESHEN
email:bashkia@bashkiamirdite.gov.al tel dhe fax : (00355) (0) 2162233 www.bashkiamirdite.gov.al

REPUBLIKA E SHQIPERISE

**BASHKIA MIRDITË**

**KËSHILLI I BASHKISË MIRDITË**

Nr4235/prot 2 Rreshen me 24/09/2026

**P/V E N D I M**
**Nr. 96 date. 24. 9. .2026**

"PËR PERDORIM FOND REZERVE "

Mbështetur në ligjit 139/2015 " Për vetëqeverisjen vendore", në ligjin Nr. 9936 date 26.06.2008 " Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", ne ligjin nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", 87/2025, "Per buxhetin e vitit 2026" "Udhëzimin Nr.9 datë 20.07.2018 "Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit", në udhëzimin nr.2, datë.14.01.2026, "Për zbatimin e buxhetit 2026", ,ne VKB nr.98 datë 10.12.2025 "Për miratimin e buxhetit të vitit 2026", në relacionin, nr.4235/1 prot, datë.23.09.2026, "Mbi vlesimin e situates financiare dhe sociale te z.Marte Zef Gjoka dhe Margjela Nikoll Pjetri", e sektorit të shërbimit social, Bashkia Mirditë, këshilli i bashkisë Mirditë pasi diskutoi rreth projektit të paraqitur nga Kryetari i bashkise

**V E N D O S I:**

***I-Të perdorë nga fondi Rezerve shumën 200 000 lekë, për dhënie ndihmë financiare si më poshte;***

1. 1. Të japë ndihmë financiare familjes së z. z.Marte Zef Gjoka ID;F25312017L dhe Margjela Nikoll Pjetri, ID: E55815029U,, banues në NJA Fane, lagje Zallexhuxhe. për kushtet të vështira jetese.

**a-Paksim**:fondi rezervë ( AI133 00 2133001 01 V491AAA..609) për shumën ***200 000 lekë***
***b-Shtohet*** (AA133 00 2133001 01 V111AAA.....606) për shumën ***200 000 lekë***
.2.Pagesa te kaloje ne degen e Postes Mirdite, zyra Postare Rreshen, ne emer te seciles, me nga 100 000 leke .

***II-.Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet sektori e finances dhe buxhetit.***

***III-.Ky vendim hyn në fuqi 10 (dhjetë) ditë pas shpalljes.***

**SEKRETARI**
**Gaspër TOPOLLAJ**

**KRYETARI**
**Aleksander PICAKU**

**Paraqiten projektin**

Dr.Finance/buxhet:: V.Gjoka

Pergj sekt juridik: L..Gjergji

**KRYETARI**
**Albert MËLYSHI**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA MIRDITË

ADRESA: SHESHI "ABAT DOÇI", RRESHEN
email:bashkia@bashkiamirdite.gov.al tel dhe fax : (00355) (0) 222162223www.bashkiamirdite.gov.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA MIRDITË**

**AGJENCIA E SHËRBIMIT SOCIAL DHE STREHIMIT**

SEKTORI I NDIHMËS EKONOMIKE PAAFTËSISË DHE STREHIMIT SOCIAL

**Nr**4235/1 **prot** **Rrëshen, më** 23 /09 / **2026**

**Lënda:** Relacion

**Drejtorisë së Financës**

**Bashkia Mirditë**

Lidhur mbi verifikimin e bërë na zyra e NE e Njësisë Administrative Fan, në banesën e shtetaseve, Margjela Nikoll Pjetri, e lindur në Vilë, më 15.08.1945, me ID E55815029U, dhe Marte Zef Gjoka, e lindur në Bisakë, më 12.03.1952, me ID F25312017L, po ju japim relacionin si më poshtë:

Zonjat e moshuara jetojnë në një shtëpi përdhesë në lagjen Zallxhuxhë të Fanit. Të moshuarat ndodhen në gjendje mjaft të vështirë ekonomike. Nga pensioni ato përfitojnë gjithsej shumën prej 23 500 lekë në muaj, shumë e pamjaftueshme për të përmbushur shpenzimet e nevojshme për ushqim, gjëra materiale dhe ilaçe. Banesa ku të moshuarat jetojnë është shumë e vjetër, mban lagështirë, çatia pikon, muret janë të dëmtuara, pra është në kushtet e amortizimit.

Prandaj, si Shërbim Social kërkojmë që situata e tyre të merret në konsideratë dhe t'u jepet një mbështetje financiare sipas mundësive.

Konceptoi: Përgj.Sekt. Roza Preçi

Miratoi: Drejtori Gjergj Përgjoni